

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6238  
E premte, 12 shkurt 2021  
çmimi 0.40 €

## NATO-ja njofton për hapjen e linjave të reja në hapësirën e ulët ajrore të Kosovës

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", MUHARREM NITAJ | FAQE 4-5

## NË KOMUNAT QË QEVERISIM, AAK-ja DO TË DALË E PARA

Shefi i Shtabit Zgjedhor i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka bërë me dije se në këto zgjedhje kjo parti ka mobilizuar jo vetëm elektoratin tradicional të saj. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se më 14 shkurt këtë parti do ta votojnë edhe njerëz që nuk kanë qenë pjesë e AAK-së më parë. Nënkryetari i AAK-së ka theksuar se kjo parti do të dalë e para në shtatë komunat që është duke qeverisur. Ai ka hedhur poshtë rezultatet e sondazheve të publikuara deri më tani, të cilat ka thënë se kanë qenë të porositura



### OPINION

#### PËR KOSOVËN... BIDENI DUHET TA KAPËRCEJË TRUMPIN DHE... VETEN F. 11

Shkruan: Mentor NAZARKO



### AKTUALE



#### POLICIA E PËRGATITUR PËR TA ZBATUAR PLANIN OPERATIV PËR ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT F. 3

## QEVERIA LEHTËSON MASAT KUNDËR COVIDIT



Qeveria në detyrë e Kosovës ka marrë vendim të enjten për lehtësimin e masave të pandemisë Covid-19. Me vendimet e reja orë policore nuk do të ketë në asnjë qytet të Kosovës, studentët do t'i vazhdojnë ligjëratat në objekte të fakulteteve, kurse orari i punës së operatorëve ekonomikë në gjithë Kosovën do të jetë nga ora 5:00 deri në orën 22:00 | FAQE 8-9

## Rreth 16 mijë pako, të supozuara me fletëvotime, kanë ardhur nga diaspora | FAQE 5



#### KLINIKA E RADIOLOGJISË, SHIFRA REKORDE TË PUNËS F. 6

### AKTUALE

#### NDAHEN 600 MILIONË EURO PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE F. 9

#### NËNSHKRUHET MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NË MES TË ATK-SË DHE AKK-SË F. 9

### KULTURË

#### CERTIFIKOHEN 30 KURSISTË PËR PËRPUNIMIN E ZEJES SË FILIGRANIT NË PRIZREN F. 10

### SPORT

#### DUKAGJINI KUALIFIKOHET NË ÇEREKFINALE TË KUPËS F. 12

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Merkeli i pranon të metat e vendimeve për valën e dytë të pandemisë

BERLIN, 11 SHKURT - Kancelarja gjermane Angela Merkel i ka pranuar të metat në përgjigjen e Gjermanisë ndaj valës së dytë të koronavirusit, gjatë një fjalimi të enjten në parlament. Ajo u ka thënë ligjvënësve se Gjermania e ka kaluar valën e parë të pandemisë relativisht mirë. "Më pas nuk kemi qenë mjaftueshëm të kujdesshëm apo të shpejtë", ka thënë ajo, duke shtuar se për izolimin e dytë, që ka hyrë në fuqi nga nëntori, nuk është vendosur me kohë.

Të mërkurën Merkel dhe kryetarët e 16 landeve gjermane

janë pajtuar për t'i shtyrë masat e izolimit deri më 7 mars. Kjo nënkupton që restorantet, dyqanet, muzetë dhe institucionet e tjera do të mbesin të mbyllura. Megjithatë, administratat shtetërore kanë marrë vendime të tjera, veç e veç, për rihapje të shkollave dhe kopshteve për fëmijë, duke nisur nga 22 shkurti.

Përveç kësaj, floktaritet do të lejohen të hapen nën masa të rregullta të higjienës nga 1 marsi. Kancelarja Merkel ka thënë të enjten se zgjatja e izolimit, ka qenë e domosdoshme. "As edhe për një

ditë nuk harroj se çka nënkuptojnë masat e domosdoshme për secilin njeri: kufizim të përkohshëm të lirisë që nuk është përjetuar kurrë më parë në republikën federale, barrë të rëndë personale, vetmi, shqetësime ekonomike dhe frikë ekzistenciale. Nuk do ta harroj këtë gjë as edhe një ditë", ka thënë Merkel.

Sipas të dhënave të Institutit "Robert Koch", 2.3 milionë persona në Gjermani janë infektuar me koronavirus prej shpërthimit të pandemisë. Prej këtyre, 63 636 persona kanë vdekur.



## Holanda do t'i paguajë nga 5 000 euro ushtarët që ishin në Srebrenicë



AMSTERDAM, 11 SHKURT - Qeveria holandeze ka njoftuar se do t'i paguajë nga 5 000 euro të gjithë veteranët e ushtrisë që kanë shërbyer në kuadër të misionit paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara në Srebrenicë të Bosnje dhe Hercegovinës.

Pagesa do të bëhet për, siç është thënë, "shërbimin e tyre në kushte të tmerrshme".

Më 1995 misioni i Kombeve të Bashkuara nuk arriti ta parandalonte gjenocidin ndaj myslimanëve të Bosnjës, raporton AP. Holanda ka pasur në Bosnje rreth 850 ushtarë.

Trupat holandeze kanë qenë të pranishëm në Srebrenicë kur luftëtarët serbë të Bosnjës të armatosur rëndë dhe të udhëhequr nga gjenerali Ratko Mlladiq hynë në qytet dhe vranë e masakruan më shumë se 8 000 burra dhe djem myslimanë. Mlladiqi është dënuar për gjenocid nga Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi në Hagë.

Prej kohësh, Holanda është ballafaquar me pasojat e kësaj ngjarjeje. Qeveria e ish-kryeministrit Eim Kok dha dorëheqjen më 2002 pasi

autoritetet holandeze kritikuan ashpër dërgimin e trupave në zonën e rrezikut pa armë dhe autoritet të duhur për të mbrojtur rreth 30.000 refugjatëve që u larguan në një bazë holandeze në Bosnjën Lindore. Më 2019, Gjykata e Lartë e Holandës vendosi që Holanda ishte pjesërisht përgjegjëse për vdekjet e rreth 350 myslimanëve që u vranë nga forcat serbe të Bosnjës. Në anën tjetër, Kombet e Bashkuara janë kritikuar që nuk miratuan sulmet ajrore për të mbështetur trupat holandeze në terren.

## Lirohet nga burgju aktivistja saudite Loujain al-Hathloul

Riyadh, 11 shkurt - Aktivistja e shquar e të drejtave të grave në Arabinë Saudite, Loujain al-Hathloul, është liruar nga burgju. Ajo qëndroi për tri vjet në paraburgim dhe rasti i saj kishte shkaktuar zemërim të bashkësisë ndërkombëtare. "Loujain është në shtëpi", ka shkruar në "Tëitter", motra e saj, Lina al-Hathloul.

Hathloul, 31-vjeçare, është aktiviste e njohur e Arabisë Saudite e cila zhvilloi fushata të gjëra për të drejtën e grave për të vozitur makinën dhe për t'i dhënë fund sistemit të kujdestarisë nga burrat. Në



vitin 2018 ajo u arrestua së bashku me disa gra tjera. Disa javë pas arrestimit të tyre ky

vend vendosi të lejojë gratë që të drejtojnë makinat. Në dhjetor të vitit 2020, një

gjykatë e dënoi aktivistën Hathloul me gati gjashtë vjet burgim mbi akuzat për lidhje me terrorizmin, por një pjesë e dënimit ishte pezulluar duke hapur rrugën për lirimin e saj të parakohshëm. Edhe pse është lënë e lirë ajo ende është në vëzhgim dhe i ndalohej largimi nga Arabia Saudite. Lirimi i saj nga burgju ndodhë në kohën kur presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden po i rishqyrton raportet me Arabinë Saudite, në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut dhe përfshirjen saudite në luftën e Jemenit.

Gjatë një fjalimi në Pentagon, presidenti Biden e mirëpriti lajmin për lirimin e aktivistes saudite. Organizatat e të drejtave të njeriut gjithashtu e mirëpritën lirimin e saj, por kërkuan që edhe aktivistet tjera të lirohen.

Sundimtari de fakto i Mbretërisë, Princi i Kurorës, Muhamed bin Salman, është përpjekur të marrë vendime të cilat do ta paraqisnin atë si reformator. Megjithatë kritikët raportojnë për masa të vazhdueshme ndaj aktivistëve dhe rivalëve brenda monarkisë.

## ShBA-ja, thirrje Turqisë të heqë dorë nga armatimi rus

UASHINGTON, 11 SHKURT - Shtetet e Bashkuara kanë përsëritur thirrjen drejtuar Turqisë që të tërhiqet nga furnizimi me sistemin rus të mbrojtjes raketore. Ministri i Mbrojtjes i

Turqisë, Hulusi Akar, gjatë një interviste këtë javë u shpreh në favor të një zgjidhjeje kompromisi për sistemin rus S-400, të cilin Rusia fillimisht e ndërtoi për t'i shënjestruar

aeroplanët luftarakë perëndimorë. Por, ShBA-ja nuk është e interesuar për ofertën turke. "Politika jonë për sistemin S-400 nuk ka ndryshuar", ka thënë zëdhënësi

i Departamentit të Shtetit, Ned Price, kur u pyet në lidhje me propozimin turk. "Ne kemi kërkuar dhe do të vazhdojmë të kërkojmë nga Turqia të mos e mbajë këtë sistem", ka thënë ai.



# Policia e përgatitur për ta zbatuar planin operativ për zgjedhjet e 14 shkurtit



Të enjten në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës është mbajtur një takim lidhur me angazhimin e policisë në zbatimin e planit operativ për 'Zgjedhjet e parakohshme parlamentare' të 14 shkurtit. Policia e Kosovës do të angazhojë një numër të mjaftueshëm të zyrtarëve policorë të profileve të ndryshme që iu përkasin njësiteve të ndryshme brenda policisë si dhe ka marrë masa shtesë duke caktuar edhe koordinatore të policisë me KQZ-në dhe institucionet e tjera të angazhuara në këtë proces

**EPOKA ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 SHKURT - Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës është mbajtur një takim lidhur me angazhimin e policisë për zbatimin e planit operativ për 'Zgjedhjet e parakohshme parlamentare'. Takimi është udhëhequr nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, në të cilin kanë marrë pjesë menaxhmenti i lartë i PK-së: drejtorët e departamenteve, drejtorët e divizioneve dhe drejtorive rajonale, të cilët janë

njoftuar lidhur me planifikimet, vlerësimet dhe angazhimet policore për ofrimin e sigurisë dhe mbarëvajtjes së procesit zgjedhor, si një proces mjaft i rëndësishëm për vendin. Drejtori Mehmeti gjatë këtij takimi ka theksuar se përmes realizimit të planit operativ duhet të krijohet një ambient i sigurt dhe i qetë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës përmes mbajtjes së rendit, qetësisë dhe sigurisë publike në vend para, gjatë dhe pas procesit të zgjedhjeve. Planifikimi operativ ka paraparë implementimin dhe realizimin e operacionit policor në katër

faza, siç është filluar nga periudha parazgjedhore apo përgatitore vlerësuese, pastaj angazhimi në ofrimin e sigurisë gjatë fushatës parazgjedhore, angazhimi dhe garantimi i sigurisë në fazën kyçe të ditës së zgjedhjeve si dita (Z), si dhe periudha pas zgjedhjeve që parasheh transportin nën përcjellje dhe siguri të PK-së të materialit sensitiv e deri në përfundim të procesit. Policia e Kosovës do të angazhojë një numër të mjaftueshëm të zyrtarëve policorë të profileve të ndryshme që iu përkasin njësiteve të ndryshme brenda

policisë, si dhe ka marrë masa shtesë duke caktuar edhe koordinatore të policisë me KQZ-në dhe institucionet e tjera të angazhuara në këtë proces. Në këtë takim me të pranishmit u diskutua edhe për iniciimin dhe procedimin e çdo veprë penale kundër të drejtës së votimit dhe ndërmarrjes së të gjitha masave procedurale/penale ndaj çdokujt që bie ndesh me ligjet e vendit që rregullojnë/sanksionojnë veprimet e kundërligjshme ndaj zgjedhjeve të lira dhe demokratike, në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Shtetit sipas planeve të veprimit dhe marrëveshjeve paraprake të bazuara në ligj. Në këtë takim është theksuar se Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për realizimin e detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore në mënyrë profesionale, transparente dhe të paanshme karshi qytetarëve dhe vendit, andaj i inkurajon të gjithë qytetarët që të bashkëpunojnë me Policinë e Kosovës dhe të raportojnë për çdo rast të kundërligjshëm që ndërlidhet me sigurinë dhe procesin zgjedhor apo edhe jashtë tyre.

## Më 15 shkurt nuk mbahet mësim në shkollat që do të jenë qendra të votimit

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka kërkuar nga drejtoritë komunale të arsimit, që të hënë, më 15 shkurt 2021, të mos mbahet mësimi në shkollat që një ditë më parë kanë qenë qendra votimi, në mënyrë që të mbrohet shëndeti i nxënësve, mësimitdhënësve dhe stafit tjetër të shkollës nga pandemia Covid-19. Këtë kërkesë MASH-i e ka bërë për arsye se në këto shkolla gjatë ditës së zgjedhjeve do të ketë frekuentim të madh të

aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor. MASH-i ka kërkuar që këto shkolla të ajrosen mirë dhe të dezinfektohen në mënyrë që të martën, më 16 shkurt, të jenë të gatshme për mbajtjen e mësimi. Ministria e Arsimit dhe Shkencës bën me dije se dita e humbur e mësimi do të zëvendësohet dhe DKA-të në bashkëpunim me shkollat duhet të vendosin për ditën e përshtatshme që mund të zëvendësohen orët e humbura.

## KMDLNj: Votat nga diaspora mund t'i mbrojnë vetëm KQZ-ja

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) përmes një reagimi për media ka theksuar se votat nga diaspora mund t'i mbrojnë vetëm Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). KMDLNj ka bërë me dije se shumë qytetarë nga shtetet e ndryshme të Evropës i janë drejtuar këtij institucioni me ankesë se nuk janë thirrur me telefon për verifikim apo se brenda një familjeje prej

gjashtë anëtarëve me të drejtë vote, janë thirrur vetëm dy anëtarë, ndërsa katër të tjerë nuk janë thirrur. "Qytetarët e Kosovës që jetojnë përkohësisht në shtetet e tjera e që janë shtetas të Kosovës sikur edhe ata që e kanë dyshetësinë kanë kërkuar që e drejta e tyre për të votuar të mbrohet sikur edhe të mbikëqyret në rast se ka dyshime për mohim të kësaj të drejte. Në këtë kontekst, KQZ-ja si autoritet me mandat kushtetues për

organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve të 14 shkurtit 2021 ka dhënë zotime publike se asnjë votues, pavarësisht se ku jeton e që i plotëson kushtet ligjore për të votuar, do të votojë dhe në asnjë rast nuk do t'i mohohet e drejta për votim, si e drejtë e njeriut e që garantohet me ligjet e zbatueshme në Kosovë dhe KMDLNj nuk dyshon aspak në profesionalizmin dhe korrektësinë e KQZ-së. KQZ-ja deri më tani në mënyrë



shembullore i ka organizuar zgjedhjet në Kosovë falë korrektësisë dhe bashkëpunimit të anëtarëve

të KQZ-së që përfaqësojnë të gjitha subjektet politike", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.



FLET PËR "EPOKËN E RE", MUHARREM NITAJ

# Në komunat ku qeverisim, AAK-ja do të dalë e para

Shefi i Shtabit Zgjedhor i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka bërë me dije se në këto zgjedhje kjo parti ka mobilizuar jo vetëm elektoratin tradicional të saj. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se më 14 shkurt këtë parti do ta votojnë edhe njerëz të ri që nuk kanë qenë pjesë e AAK-së më parë. Nënkyetari i AAK-së ka theksuar se kjo parti do të dalë e para në shtatë komunat që është duke qeverisur. Ai ka hedhur poshtë rezultatet e sondazheve të publikuara deri më tani, duke thënë se kanë qenë të porositura

po përmend as shifra e as përqindje. Mjafton të them se besoj në rezultatit më të mirë që Aleanca e ka pasur ndonjëherë!", është shprehur Nitaj.

Ai ka hedhur poshtë rezultatet e sondazheve të publikuara deri më tani, duke thënë se kanë qenë të porositura. "E kanë krijuar një kaos sondazhet. Ato janë të domosdoshme në kohë fushatash, por jo këso çfarë janë bërë këtë herë në Kosovë. Shumë prej tyre kanë qenë me rezultat të porositur dhe kjo është shqetësuese. Aleanca nuk i ka marrë seriozisht! Për fat të keq, kësaj radhe nuk na ka ngelur fije besimi në to!", është shprehur ai.

Ndër të tjera, në këtë intervistë ai ka treguar edhe arsyet pse duhet të votohet kjo parti më 14 shkurt.

"Ka plot arsye pse qytetarët duhet ta votojnë AAK-në, por unë po i numëroj vetëm disa, sepse Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është garanci e mbrojtjes së Kosovës së 17 shkurtit, e kufijve të jashtëm të shtetit. Sepse falë Aleancës dhe liderit të saj Ramush Haradinaj, por edhe mbështetjes së ShBA-së, Kosova sot është me ushtri", është shprehur Nitaj.

**"Epoka e re":** Z. Nitaj, si po ju ecën fushata zgjedhore? Sa keni arritur ta mobilizoni elektoratin e AAK-së për këto zgjedhje?

**Nitaj:** AAK-ja është ndër partitë më të strukturuar në Kosovë. Është bërë një punë e jashtëzakonshme në terren dhe ka pasur një mobilizim të dukshëm, megjithëse kohë e

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 11 SHKURT - Shefi i Shtabit Zgjedhor i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, beson se kjo parti më 14 shkurt do të marrë rezultat të mirë. Ai ka thënë se në këtë fushatë zgjedhore AAK-ja ka arritur të mobilizojë edhe

elektorat të ri. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", nënkryetari i AAK-së ka treguar se kjo parti do të fitojë në komunat që është duke qeverisur. "Në shtatë komunat ku Aleanca udhëheq do të ketë votë fituese, por janë edhe disa komuna të tjera ku AAK mund të dalë më e votuara. Me një fjalë, fushata ka rezultuar mirë e

organizuar dhe që ka arritur ta mobilizojë jo vetëm elektoratin tradicional të AAK-së, por edhe njerëz të ri që nuk kanë qenë pjesë e jona më parë", ka thënë ai.

Nitaj nuk ka përmendur përqindje, por ka thënë se rezultati do të jetë më i mirë që ka marrë ndonjëherë kjo parti. "Edhe pse në kohë fushate, nuk

i kanë kontribuar një fushate “fer”, sado që ka pasur disa ngacmime të vogla.

**“Epoka e re”:** Sondazhet e publikuara deri më tani nuk po e nxjerrin mirë AAK-në. Sa u besoni këtyre sondazheve?

**Nitaj:** E kanë krijuar një kaos sondazhet. Ato janë të domosdoshme në kohë fushatash, por jo këso çfarë janë bërë këtë herë në Kosovë. Shumë prej tyre kanë qenë me rezultat të porositur dhe kjo është shqetësuese. Aleanca nuk i ka marrë seriozisht. Për fat të keq, kësaj radhe nuk na ka ngelur fije besimi në to.

**“Epoka e re”:** Pse qytetarët duhet ta votojnë AAK-në në zgjedhjet e 14 shkurtit?

**Nitaj:** Ka plot arsye pse qytetarët duhet ta votojnë AAK-në, por unë pi i numëroj vetëm disa, sepse Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është garant i mbrojtjes së Kosovës së 17 Shkurtit, i kufijve të jashtëm të shtetit. Sepse falë Aleancës dhe liderit të saj Ramush Haradinaj, por dhe mbështetjes së ShBA-së, Kosova sot është me ushtri. Sepse vetëm këmbëngulësia e Aleancës dhe e kryeministrit Haradinaj, e ka mënjanuar rrezikun real të copëtimit të Kosovës dhe ndryshimit të kufijve të saj. Sepse Aleanca e Kosovës me Ramush Haradinajn në krye, e ka realizuar pavarësinë energjetike të vendit dhe ia ka rikthyer Kosovës tapitë mbi Trepçën. Sepse Aleanca për anëtarësinë e vet, sado qoftë në përqindje, por edhe për të tjerë qytetarë që mund të kenë përkatësi të ndryshme apo që janë pa parti, do të vazhdojë të jetë garanci e ekzistencës së shtetit të Kosovës, integritetit e sovranitetit të tij, por edhe jetesës me dinjitet të qytetarëve, pavarësisht çfarë etnie apo partie kanë. Sepse AAK-ja sot është një parti e profilizuar e me njerëz të përgatitur e të zotë për të marrë përgjegjësi qeverisëse e drejtuese në të gjitha nivelet. Sepse Aleanca, me kandidatin e saj për president, Ramush Haradinaj, një njeri të dëshmuar në të gjitha etapat, të luftës e të shtetndërtimit, të vendosur e të pakompromis për interesin e vendit, do të jetë garanti më i mirë i ruajtjes, mbrojtjes dhe zhvillimit të shtetit. Ka edhe shumë sepse të tjera që shpresoj t'i kemi shpalosur në fushatën që përmbyllët sot!

vëshirë pandemie. Ne jemi të kënaqur sepse qytetarët kanë ardhur dhe na kanë dëgjuar. Na kanë dhënë mbështetje për idetë dhe programin e shpalosur. E kemi vërejtur një mobilizim edhe në mjediset kur nuk kemi qenë aq të fortë në fushatat e mëparshme. Në shtatë komunitat ku Aleanca udhëheq do të ketë votë fituese, por janë edhe disa komuna të tjera ku AAK-ja mund të dalë më e votuara. Me një fjalë, fushata ka rezultuar mirë e organizuar dhe që ka arritur ta mobilizojë jo vetëm elektoratin tradicional të AAK-së, por edhe njerëz të ri që nuk kanë qenë pjesë e jona më parë.

**“Epoka e re”:** Ndryshe nga partitë e tjera, z. Haradinaj dhe zyrtarët e kësaj partie nuk po përdorin gjuhë kritike ndaj subjekteve të tjera politike. Pse po ndodh kjo?

**Nitaj:** Aleanca gjithmonë ka qenë e kujdesshme në diskursin e vet publik në kohë fushate. Ajo nuk e ka përdorur fushatën negativiste. Këtë herë ka qenë edhe më e kujdesshme. Po nuk është se edhe partitë e tjera nuk

# Qeveria lehtëson masat kundër Covidit

Qeveria në detyrë e Kosovës ka marrë vendim të enjten për lehtësimin e masave të pandemisë Covid-19. Me vendimet e reja orë policore nuk do të ketë në asnjë qytet të Kosovës, studentët do t'i vazhdojnë ligjëratat në objekte të fakulteteve, kurse orari i punës së operatorëve ekonomikë në gjithë Kosovën do të jetë nga ora 5:00 deri në orën 22:00

**EPOKA E RE**

**Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 11 SHKURT** - Me kërkesë të kryeministrit në detyrë të Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, në pajtim me rregulloren e punës së qeverisë, është mbajtur mbledhja korresponduese elektronike, e 63-ta me radhë, në të cilën është shqyrtuar dhe miratuar vendimi për masat e përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19.

Në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës dhe duke marrë parasysh dispozitat e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për masat si dhe obligimet e institucioneve për zbatimin e këtyre masave.

Me këtë vendim, për komunitat të cilat janë në zonat e kuqe, është hequr ora policore, pra nuk do të ketë më kufizim të lëvizjes së qytetarëve. Studentët do t'i vazhdojnë ligjëratat në objektet e fakulteteve, me prani fizike dhe jo online. Së këndejmi, të gjithë operatorëve ekonomikë në komunitat që janë në zonën e kuqe do t'u lejohet të punojnë deri në orën 22:00.

Mes të tjerash, në njoftim është thënë se në tubimet publike, të organizuara në ambiente të hapura, mund të marrin pjesë 80 persona, derisa në ato të mbyllura deri në 50 persona, për dallim nga 30 persona sa janë lejuar në hapësira të mbyllura dhe 50 në ato të hapura deri më tani.

Procesi arsimor në të gjitha institucionet e arsimit të lartë,

publik dhe privat, si dhe provimet, punët praktike dhe laboratorike të organizohen sipas planprogramit të institucioneve përkatëse në përputhje me “Manualin për mbrojtje nga përhapja e Covid-19”.

Veprimtaria e çerdheve publike dhe private vazhdon sipas vlerësimit dhe mbikëqyrjes nga autoritetet komunale, bazuar në “Manualin për mbrojtje nga përhapja e Covid-19”, përfshirë matjen e temperaturës së fëmijëve dhe stafit në baza ditore gjatë hyrjes në objekte.

Konviktet dhe mensat punojnë duke respektuar manualin për mbrojtje dhe përhapjen nga Covid-19. Të gjitha institucioneve arsimore në të gjitha nivelet e arsimit, publik dhe privat, iu ndalohet organizimi i aktiviteteve jashtë mësimore, siç janë ekskursionet, shëtitjet grupore, ahengjet e ndryshme të stafit mësimesor dhe nxënësve - studentëve dhe të ngjashme.

Mikrobiologu Lul Raka, kryesues i bordit këshillëdhënës për koronavirus, ka thënë se nuk është konsultuar për një propozim të tillë. Ky bord është formuar nga ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj.

Përmes një postimi në rrjetin social “Facebook”, ai ka thënë se kundërshton lirimin e masave në këtë kohë. “Në kohën e shkeljes të masave parandaluese gjatë fushatës zgjedhore e parazgjedhore nga tërë spektri politik, shtrirjes së variantit britanik të virusit, i cili është i pranishëm në Kosovë që nga fundi i dhjetorit, çdo ‘lehtësim politik i masave’ mundëson përhapjen e infeksionit në komunitet duke kërcënuar shëndetin publik e individual në

Kosovë. Prandaj, unë jam kundër lirimit të masave në këtë kohë”, ka thënë ai.

Kosova aktualisht po përballet me fushatë zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit.

Nëpër shumë organizime të partive politike, që marrin pjesë në këto zgjedhje, janë parë qindra persona nëpër ambiente të mbyllura, pa respektuar distancën fizike dhe me raste pa mbajtura as maska.

## Kosova regjistron edhe dy viktima dhe 344 të infektuar me Covid

Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të enjten 344 persona të infektuar me Covid-19, pas testimit të 2 281 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar dy viktima me këtë virus. “Rastet e të vdekurve janë nga komunitat: Skenderaj 1 rast (63 vjeç), Viti 1 rast (85 vjeç)”, është thënë në njoftimin e IKShPK-së. Sipas IKShPK-së, nga sëmundja Covid-19, që shkakton koronavirusi, të enjten janë shëruar 230 persona, derisa raste aktive janë 7 008. Prej 13 marsit, kur janë regjistruar rastet e para me koronavirus në Kosovë, autoritetet shëndetësore në këtë shtet kanë regjistruar 63 433 persona të infektuar me këtë virus. Prej tyre, 1 534 pacientë kanë vdekur.



## Rreth 16 mijë pako të supozuara me fletëvotime kanë ardhur nga diaspora

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka bërë me dije se në këtë institucion kanë arritur 15 966 pako të supozuara me fletëvotime nga diaspora. Elezi ka thënë për "Epokën e re" se pranimi i këtyre pakove është duke u

bërë me përcjellje të policisë dhe vëzhguesve të partive politike. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është duke vazhduar të pranojë pako të supozuara me fletëvotime të cilat po vijnë nga jashtë vendit në kuadër të periudhës së votimit përmes postës. Deri më tani (e enjte, ora

16:00) numri i pakove të supozuara me fletëvotime që janë pranuar është: 15 966. Pranimi i këtyre pakove po bëhet me përcjelljen e Policisë së Kosovës si dhe vëzhguesve të subjekteve politike dhe organizatave joqeveritare të akredituara", ka thënë Elezi.



## NATO-ja njofton hapjen e linjave të reja në hapësirën e ulët ajrore të Kosovës



PRISHTINË, 11 SHKURT - NATO-ja ka njoftuar për hapjen e linjave të reja në hapësirën e ulët ajrore mbi Kosovën. Në një njoftim të Aleancës Veri-Atlantike thuhet se kjo është një arritje e rëndësishme për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore mbi Kosovën. Kjo masë, sipas njoftimit, do ta përmirësojë trafikun ajror civil nga dhe në aeroportin e Prishtinës. "Përfitimet do të vërehen në udhëtime më të shpejta, më pak shpenzim të karburanteve dhe ulje të ndotjes së ajrit", thuhet në njoftim.

Që nga viti 1999 procesi i normalizimit të hapësirës ajrore të Kosovës është mbështetur në vazhdimësi nga NATO-ja. Kjo është bërë në kuadër të takimeve për Normalizimin e Aviacionit në Ballkan, në kuadër të cilave kanë marrë pjesë përfaqësues të vendeve aleate, autoritetet e aviacionit, ato

ushtarake dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare, përfshirë Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit.

Në vitet e fundit NATO përmes takimeve të normalizimit të aviacionit në Ballkan ka lehtësuar zyrtarizimin e një Marrëveshje Kuadër midis KFOR-it dhe Islandës. Agjencia e Sigurisë së Transportit të Islandës (ICETRA) tani po vepron si një funksion i mbikëqyrjes së sigurisë dhe ofron mbështetje për komandantin e KFOR-it.

Në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Marrëveshjen Teknike Ushtarake të vitit 1999, por edhe me ligjet e tanishme në Kosovë, komandanti i misionit të KFOR-it, përkatësisht NATO-s, është përgjegjës për sigurinë e hapësirës ajrore të Kosovës.

## Klinika e Radiologjisë, shifra rekorde të punës

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Klinika e Radiologjisë ka prekur shifra rekorde të ofrimit të shërbimeve mjekësore për pacientët në vitin 2020, ndonëse në kohë të pandemisë Covid-19, kur shumica e shërbimeve ishin kufizuar në QKUK, me qëllim të parandalimit të përhapjes së infeksionit. Gjatë kësaj kohe janë realizuar më tepër se 80 mijë radiografi, më shumë se 21 mijë tomografi të kompjuterizuara dhe mbi 1 400 angiografi me tomografi të kompjuterizuara. Duke marrë për bazë raportin

vjetor të punës, me angazhimin e personelit shëndetësor, në Klinikën e Radiologjisë janë kryer edhe 9 800 rezonanca magnetike, 1 700 mamografi dhe më shumë se 15 mijë ultrazëra.

Në periudhën 12-mujore të vitit të shkuar, gjithashtu janë bërë 32 DSA (angiografi digjitale subtraksionale), 395 biopsi dhe për herë të parë në historinë e shëndetësisë së Kosovës me trombektomi mekanike janë trajtuar pesë pacientë, me infarkt të freskët iskemik në tru dhe janë kthyer nga invaliditeti brenda gjashtë orëve të para.



## Zoran Gjokiqi dënohet me 12 vjet burgim për krime lufte

PRISHTINË, 11 SHKURT - Zoran Gjokiqi është shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Prishtinë për kryerje të krimeve të luftës në rajonin e Pejës, përkatësisht në lagjen "Kristal". Portali "Betimi për Drejtësi" raporton se Gjokiqi është dënuar të enjten me 12 vjet burgim, duke përfshirë edhe kohën e kaluar në paraburgim.

Gjokiqi akuzohet se në periudhën mars - prill të vitit 1999, përkatësisht më 29 mars 1999 ka bashkëvepruar me një grup të organizuar kriminal të nacionalitetit serb dhe besohet se ka shkuar në lagjen "Kristal" të Pejës, duke marrë pjesë në aksionin që kishte filluar për vrasjen dhe dëbimin e qytetarëve

shqiptarë nga shtëpitë e tyre. Prokuroria ka ngarkuar Gjokiqin se ka kryer veprat penale, krime të luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës dhe krime të luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar.



Aktivitetet e partive politike në kuadër të fushatës për zgjedhjet e 14 shkurtit

## Ministri i Jashtëm i Togos mbështet Hoxhaj për kryeministër

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Ministri i Jashtëm i Togos, Robert Dussey, ka mbështetur Enver Hoxhaj në kandidaturën e tij për kryeministër. Përmes një videoje, ai u drejtohet qytetarëve të Kosovës, duke thënë se Enver Hoxhaj është një kampion i diplomacisë dhe një burrështetas që ka bërë punë të madhe për vendin. "Kam kënaqësinë ta bëj këtë deklaratë në një ditë të rëndësishme për Kosovën, kur miku im i mirë, Enver Hoxhaj, po kandidon për kryeministër të vendit tuaj të bukur. Unë kam qenë atje pesë vjet më parë. Unë e njoh Enverin për shumë vite. Ne kemi punuar së bashku për t'i vendosur marrëdhëniet diplomatike midis vendit tim, Togos, në Afrikën Perëndimore, dhe

Limaj nga Lidhja e Prizrenit: Shihemi më 14 shkurt në ditën e fitores së çlirimtarëve

PRIZREN, 11 SHKURT (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, nga Lidhja e Prizrenit u është drejtuar me një mesazh të gjithë qytetarëve të vendit. Ai ka thënë se nga ky vend historik i kombit tonë, fryma çlirimtare është bartur brez pas brezi. Lideri i Nismës ka thënë se më shumë se kurrë na duhet kjo frymë çlirimtare, e cila u bart në kushte dhe rrethana shumë më të vështira, por falë burrave të mëdhenj të këtij kombi arritën që në rrethana të vështira ta ruajnë traditën, kulturën, identitetin e, mbi të gjitha, gjuhën e kombit tonë. "Lidhja e Prizrenit është lidhja e besës, lidhje e kombit rreth idealeve, traditave dhe vlerat tona kombëtare. Nga



rreshtuar me çlirimtarët. Shihemi më 14 shkurt në ditën e fitores së madhe të çlirimtarëve", ka thënë Limaj.

Hoti premton heqjen e doganës për autobusët e rinj

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryeministër, Avdullah Hoti, premtoi të mërkurën se qeveria që ai do ta drejtojë, pas 14 shkurtit do ta heqë doganën për importin e autobusëve të rinj. Gjatë një vizite që i bëri kompanisë "24 Yjet", kryeministri Hoti tha se e ka vendosur në prioritetet e qeverisë së tij mbështetjen për kompanitë e transportit, në mënyrë që edhe qytetarëve të Kosovës t'u mundësohet qarkullimi komod. Kryeministri Hoti tha se lirimi nga dogana për importin e autobusëve të rinj do të bëhet në tre muajt e parë të qeverisë që ai do të vazhdojë ta drejtojë. Drejtori i kompanisë "24 Yjet", Gani Sinani, gjatë bashkëbisedimit me kryeministrin Hoti, tregoi sfidat dhe vështirësitë me të cilat janë përballur transportuesit kryeqytetas në kushtet e krizës së pandemisë dhe pa mbështetjen e nivelit lokal të qeverisjes.

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) -



Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), njëherësh kandidat për president, gjatë fushatës së tij elektorale ka thënë se duhet të ruhen demokracia dhe funksionimi demokratik i institucioneve përmes sigurimit të ekuilibrit të pushteteve. "Aleanca ka qëndruar gjithmonë konsistente në temat e interesit nacional, andaj besimi për ne, Kosovës do t'i kthehet me më shumë siguri dhe stabilitet institucional", ka thënë

Haradinaj. Në takimin me qytetarët e Junikut, lideri i AAK-së ka bërë thirrje që më 14 shkurt të votohet subjekti i tij politik. Kurse në aktivitetin elektorale në Drenas, Haradinaj ka thënë se Forca e Kosovës në Drenas merr kuptimin që ka: një Kosovë e fortë dhe e sigurt.

Kurti: Fitorja e 14 shkurtit duhet të jetë sikur në Llap, pa balotazh

MITROVICË, 11 SHKURT (ER) - Kandidati për kryeministër nga Lëvizja Vetëvendosje, Albin Kurti, të enjten ka qëndruar në Mitrovicë, ndërsa ka thënë se fitorja e Lëvizjes Vetëvendosje në zgjedhjet e 14 shkurtit duhet të jetë sikurse ajo në Llap, pa balotazh e me shumicë parlamentare. Kurti ka thënë se në qeverinë e tij do t'i ndihmojë mitrovicasit më shumë



vendit tuaj të bukur, Kosovës", thotë ministri i Jashtëm i Togos. Ai thotë se në emrin e tij, dhe të kryenegociatorit të vendeve afrikane, Kaibeve dhe Paqësor me Bashkimin Evropian, shpreson se të punojë përsëri me Enver Hoxhaj. "I uroj të gjitha të mirat në përpjekjet e tij për ta udhëhequr Kosovën", ka thënë ministri i Jashtëm i Togos, Robert Dussey.

Lidhja e Prizrenit, te shpallja e pavarësisë në Vlorë e deri te lufta UÇK-së, kemi pasur rreshtimin e pandalshëm të çlirimtarëve që në periudha dekada me radhë deri te liria e Kosovës. Edhe sot ne vazhdojmë me dinjitet e krenari këtë rrugë të këtyre burrave, rrugën çlirimtare të rreshtuar si çlirimtarë për ta përcjell te brezat që vijnë. Fryma çlirimtare siç është bartur, është detyra jonë ta bartim te gjeneratat e reja, prandaj edhe sot gjithë Kosova është



# Ndahen 600 milionë euro për ujitjen e tokave bujqësore



**Ministri në detyrë i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, së bashku me kryetarin e Komunës së Pejës, Vitisë dhe Vushtrrisë, kanë nënshkruar marrëveshjen për bashkëfinancimin e projektit “Ndërtimi dhe rehabilitimi i sistemeve të ujitjes në Kosovë”**

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINE, 12 SHKURT - Ministri në detyrë i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka nënshkruar të enjten marrëveshjen për bashkëfinancimin e projektit “Ndërtimi dhe rehabilitimi i sistemeve të ujitjes në Kosovë”, me kryetarin e Komunës së Pejës, Vitisë dhe Vushtrrisë. Mustafa ka thënë se projekti për masterplanin për ujitjen e tokave bujqësore është në vlerë 600 milionë euro dhe do të

zbatohet në 10-12 vjetët e ardhshëm për të përfshirë nën ujitje edhe 70 mijë hektarë tokë bujqësore në tërë vendin. Sipas tij, në ditët e ardhshme do të fillojë nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit edhe me komunat e tjera në vend. “Kjo është faza e parë e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Bujqësisë dhe komunave anekënd Kosovës për të vënë në realizim ekzekutiv masterplanin e ri për ujitjen e tokave bujqësore. Një

masterplan që ka filluar në kohën kur kryeministri aktual Avdullah Hoti ishte ministër i Financave, një marrëveshje bashkë me Bankën Botërore, ku parashihen të investohen 600 milionë euro në dhjetë dymbëdhjetë vitet e ardhshme për ta ngritur sipërfaqen e tokave nën ujitje nga 20 mijë hektarët aktualë në 90 mijë hektarë, pra 70 mijë hektarë më shumë toka nën ujitje në 10-12 vjetët e ardhshëm që i jep për herë të parë në këto 40 vjetët e fundit zgjidhje në nivel vendi problemit dhe sfidës të sistemit të ujitjes. Uroj tre kryetarët aktualë të tri komunave të Kosovës që po fillojmë realizimin e këtij projekti madhor, për të vazhduar në ditët në vijim edhe me komunat e tjera për zgjerimin dhe rehabilitimin e sistemeve për ujitje anekënd Kosovës”, u shpreh Mustafa.

Kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri, këtë marrëveshje e

ka cilësuar mjaft të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë. “Më mbetet ta përgëzoj ministrin Mustafa për iniciativën që ka marrë dhe që po e nënshkruajmë këtë marrëveshje të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë dhe tokave tona”, u shpreh ai. Ndërsa kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, tha se Kosova nuk mund të ketë zhvillim ekonomik pa zhvillimin e bujqësisë. “Kosova nuk mund të ketë zhvillim ekonomik pa atë të bujqësisë, ndërsa bujqësia nuk mund të zhvillohet në Kosovë pa shfrytëzimin e resurseve. Ministri Mustafa guximshëm e ka filluar, në fakt edhe vazhduar dhe përfunduar si imediate për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe zhvillimin e potencialit kryesor të bujqësisë”, ka deklaruar Haliti.

Edhe kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka falënderuar ministrin në detyrë

Mustafa dhe kryeministrin në detyrë, Avdullah Hoti, që po u zgjasin dorën për mbështetje fermerëve dhe bujqve në këtë kohë. “Rehabilitimi i sistemit të ujitjes - Vushtrria ka një sipërfaqe të madhe nën sistemin e ujitjes së Ibër Lepencit, ndërkohë që në këtë fazë do të rehabilitohet komplet ky sistem, pastaj për t’u zgjeruar edhe më tepër hapësirat e tokës bujqësore. Dyfishimi i subvencioneve për bujqit në këtë kohë pandemie vërtet ka ndihmuar bujqit e Komunës së Vushtrrisë që rrisin prodhimin e tyre, ndërsa ky projekt tash për ujitje do të vazhdojë ta përkrahë edhe rritjen e prodhimit vendor dhe punësimin”, u shpreh ai.

Projektin për masterplanin e ujitjes së tokave bujqësore, që është shpalosur ditë më parë, e ka mbështetur Banka Botërore e që pritet ta mbështesin edhe banka të tjera financiare ndërkombëtare.



# Ambasadori gjerman: Do ta mbështesim Kosovën për punësimin e të rinjve

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - GIZ Kosova ka dorëzuar të enjten disa pajisje për saldim të teknologjisë në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike. Me këtë rast, ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, ka thënë se përkrahja e vendit të tij në këtë sektor do të vazhdojë me qëllim që të punësohen të rinjtë e Kosovës.

Më tutje, ai ka thënë se digjitalizimi është shumë i rëndësishëm për ekonominë e vendit. "E kuptova prapë se digjitalizimi është i nevojshëm. Dhe për të qenë më një hap me tregun është më se e

nevojshme. Unë jam i lumtur për këtë bashkëpunim. Gjermania është partnerja më e madhe. Ne jemi donatorët më të mëdhenj të Kosovës. Më vjen mirë që GIZ-i ka kontribuar për Kosovën dhe është partner i saj për një kohë të gjatë. Besoj se është e rëndësishme ta vazhdojmë bashkëpunimin e punësimit të të rinjve", ka thënë Rohde. Ndërsa dekani në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Ahmet Shala, ka thënë se këto pajisje të pranuar si donacion do të ndihmojnë në trajnimin e studentëve.



# Guvernatori Mehmeti kërkon nga "The Economist" që ta trajtojë Kosovën njëjtë si shtetet tjera



PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka kërkuar përfshirjen e Kosovës si shtet në gazetën prestigjioze "The Economist". Në letërën që u është dërguar drejtuesve të kësaj gazete, guvernatori Mehmeti ka potencuar faktin se Kosova nuk paraqitet si shtet i veçantë, andaj ka kërkuar nga drejtuesit e "The Economist" që Kosova të trajtohet në mënyrë të barabartë me shtetet e tjera në seksionet përkatëse të gazetës. "Republika e Kosovës ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008 dhe që nga atëherë është njohur nga 117

shtete. Në mesin e shteteve që kanë dhënë kontributin kryesor për pavarësinë e Kosovës është edhe Britania e Madhe, e cila ishte edhe ndër vendet e para që e njohu pavarësinë e vendit tonë. Për më tepër, Kosova është anëtare me të drejta të plota në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe në institucione të tjera financiare ndërkombëtare. Kjo gazetë është një burim i rëndësishëm i analizave mbi biznesin ndërkombëtar dhe çështjet botërore, ku vëmendje e veçantë në vazhdimësi i është kushtuar edhe rajonit të Evropës

Juglindore, ku bën pjesë edhe Republika e Kosovës. Institucionet e Kosovës përpilojnë të dhëna kredibile ekonomike e financiare, në përputhje të plotë me standardet përkatëse ndërkombëtare. Ne do të ishim shumë të lumtur të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar të gjithë ndihmën e nevojshme për një qasje sa më të shpejtë në të gjitha të dhënat që mund t'ju nevojiten rreth ekonomisë dhe sistemit financiar të Kosovës", ka shkruar guvernatori Mehmeti në letërën drejtuar menaxhmentit të gazetës prestigjioze "The Economist".

# Nënshkruhet memorandum bashkëpunimi në mes të ATK-së dhe AKK-së

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Bashkëpunimi ndër-institucional i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) në vazhdimësi është duke u rritur. I fundit që u finalizua në kuadër të një memorandum bashkëpunimi është ai me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës (AKK). "Memorandumi është hartuar për bashkëpunimin e aktiviteteve ndërmjet Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe Administratës Tatimore të Kosovës. Memorandumi në fjalë shpreh vullnetin e lirë të palëve nënshkruese për ta nxitur bashkëpunimin në fushën e hetimeve të shkëlqes së konkurrencës në Kosovë dhe krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe, bazuar në parimet e barazisë dhe të përfitimit

reciprok", është thënë në komunikatën për media. Sipas kësaj komunikate, qëllimi i nënshkrimit të këtij memorandum është arritja e ujdise midis palëve nënshkruese për realizimin më të suksesshëm të misioneve të tyre të cilat përqendrohen në politikën e konkurrencës të bazuar në implementimin e rregullave për ta siguruar garën reciproke dhe të ndershme të kompanive në treg. "Duke inkurajuar ndërmarrësin dhe efikasitetin me qëllim të ofrimit konsumatorëve një zgjedhje më të gjerë, e cila e ndihmon reduktimin e çmimeve dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve, si dhe në mbledhjen e tatimeve dhe kontributeve, për ta mbështetur zhvillimin ekonomik dhe



mirëqenien e qytetarëve të Kosovës, duke tentuar që të bëhen gjithnjë e më të besueshëm dhe të respektuar, si dhe më të mirë krahasuar me administratat udhëheqëse

tatimore në Evropë, gjithnjë duke zbatuar dispozitat e ligjit bazik për procedurat, Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale, Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Ligjit

për Tatimin në Vlerën e Shtuar si dhe çdo legjislacioni tjetër që mund t'i ngarkohet për administrim të çfarëdo lloji tatimi", është theksuar në komunikatën për media.

## Nënkryetari i Gjilanit: Asnjëherë dhe askund nuk kemi bërë ndasi politike në investime

**GJILAN, 11 SHKURT (ER)** - Kuvendi Komunal i Gjilanit, nën udhëheqjen e Shpresë Kurteshit-Eminit, ka shqyrtuar dhe miratuar të enjten rregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve, statutin e Qendrës Kulturore Evropiane, vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore në Zonën "B 4" në kuadër të PRRU "Kodra e Thatë", vendimin për plotësimin e vendimit të datës 18.09.2017 për ndryshimin e destinimit të planifikuar në një pjesë të parcelës kadastrale nr. 5206-0, në kuadër të Planit Rregullues Urban "Livadhet e Arapit" në Gjilan, vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme komunale, vendimin për formimin e komisionit vlerësues të ofertave. Është miratuar edhe kërkesa për ndarjen e mjeteve financiare për deshifrimin dhe përkthimin e mbishkrimeve osmane në varreza në regjionin e Anamoravës, të cilin e paraqiti drejtoresha e Kulturës, Deniza Limani, plotësimin e vendimit për ndarjen e lokacionit për



vendosjen e shtatores së Qahil Agushit në Zhegër, duke i specifikuar parcelat, përkatësisht vendimin për lirin e bizneseve nga pagesa e taksës komunale për vitin 2021.

Po ashtu, Kuvendi u informua edhe për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2020-2021 dhe fillimin e gjysmëvjetorit të dytë.

Sa i përket emërtimit të rrugëve dhe rastit konkret në lagjen Smakaj në Cërnicë, nënkryetari i komunës, Arbër Ismajli, ka thënë se ankesa për ndërrimin e emërtimit fillestar nuk është bërë në afatin e caktuar ligjor. "Është e vërtetë që parashtruesi i ankesës ka vendosur tabelën, por ne kemi qenë të detyruar ta heqim atë, sepse ka pasur reagime të banorëve, meqë

rruga ka qenë e emërtuar në bazë të procedurave të rregullta ligjore", ka thënë ai. Në lidhje me zhdëmtimin e pasojave nga vërshimet, Ismajli ka sqaruar se vlerësimi është bërë sipas kërkesës së ministrisë, por deri tani nuk ka asgjë zyrtarisht sa i përket kompensimit. "Personalisht nuk jam optimist për këtë ndihmë sepse, sa kam dëgjuar, është një fond prej

një milionësh që qeveria e ka ndarë, ose ka menduar ta ndajë, derisa vlera e dëmit vetëm në Komunën e Gjilanit shkon në 1.5 milion euro", është shprehur Ismajli. Kurse sa i përket investimeve në infrastrukturë, ai u shpreh i bindur se asnjëherë dhe askund nuk është bërë ndasi politike, megjithëse ka ndonjë vend ku ende nuk kanë mundur të arrijnë investime.

## Certifikohen 30 kursistë për përpunimin e zejes së filigranit në Prizren



**PRIZREN, 11 SHKURT (ER)** - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, dhe drejtoresha e Drejtorisë e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sevil Limani-Kazaz, të enjten kanë bërë certifikimin e 30 kursistëve të trajnuar për përpunimin e zejes së filigranit në kursin e organizuar nga DTZHE. Me

këtë rast, kryetari Haskuka ka thënë se, përveç mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, gjatë qeverisjes së tij lokale është përkushtuar që ta lidhë tregun e punës me afatësimin profesional, duke realizuar projekte të ndryshme për trajnime artizanale dhe profesionale, nga të cilët gjatë dy vjetëve të fundit kanë

përfituar më shumë se 300 persona.

Po ashtu, kryetari Haskuka ka theksuar se kështu do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, ngaqë trashëgimia kulturore e qytetit është vlerë e çmuar dhe kur ajo lidhet me aftësimin profesional, natyrisht se do të ndikojë edhe në zhvillimin ekonomik të qytetit.

## KKSB-ja në Kamenicë diskuton për situatën e sigurisë dhe për pandeminë



**KAMENICË, 11 SHKURT (ER)** - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Kamenicës ka mbajtur mbledhjen e parë të rregullt për vitin 2021. Pjesë e kësaj mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, Qëndron Kastrati, komandanti i Stacionit Policor në Kamenicë, Florim Klaiqi, përfaqësues nga Forcat e Sigurisë së Kosovës, përfaqësues të institucioneve fetare, përfaqësues të organizatave joqeveritare, si dhe anëtarët e tjerë të KKSB-së. I pari i komunës ka thënë se u është mirënjohës të gjithë anëtarëve të KKSB-së për kontributin e dhënë si dhe

Stacionit Policor për mirënjohjen që i dha kryetarit Kastrati si shenjë falënderimi për bashkëpunimin. "Me anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) mbajtëm mbledhjen e radhës për të diskutuar për sigurinë në Kamenicë, situatën me pandeminë dhe planin e punës për vitin 2021 të këtij këshilli. U jam mirënjohës të gjithë anëtarëve për kontributin e dhënë dhe falënderoj Stacionin Policor në Kamenicë për mirënjohjen si shenjë falënderimi për bashkëpunimin mes dy institucioneve", ka thënë Kastrati.

# Për Kosovën... Bideni duhet ta kapërcejë Trumpin dhe... veten



Shkruan: Mentor NAZARKO

## Edhe Trumpi pro njohjes reciproke dy vjet më parë

Dy vjet më parë, madje disa ditë para festës serbe, Trumpi jo vetëm i ka konfirmuar të njëjtën gjë - ia përmend dy herë njohjen e ndërsjellë Vuçiqit, por i ka shkruar edhe Thaçit me rastin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës, për ta ruajtur primatin mbi dialogun mes tyre. "Ne besojmë se njohja e ndërsjellë duhet të jetë elementi qendror i një normalizimi të qëndrueshëm të marrëdhënieve. Një marrëveshje e tillë historike, me njohjen e ndërsjellë në thelbin e saj, do ta ndërtonte rrugën që ka si qëllim integrimin evropian të Serbisë dhe rritjen ekonomike", i shkruante Trumpi Vuçiqit më 15 shkurt 2019. Pothuaj të njëjtën gjë ka shkruar dhe Bideni një vit më pas: "ShBA-ja mbetet e palëkundur në mbështetjen për integrimin evropian të Serbisë, zbatimin e reformave dhe arrijtjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse mbi normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, e cila përqendrohet në njohjen reciproke". Mjafton krahasimi i këtyre dy teksteve: administrata Biden është në të njëjtën linjë me administratën Trump sa i takon njohjes reciproke. Mirëpo, ka dhe më shumë se kaq. Ajo e lidh në një mënyrë marrëveshjen me Kosovën, me integrimin evropian të Serbisë.

Ka një detaj tjetër: dy vjet më parë ambasada amerikane i ka bërë publike në të njëjtën ditë mesazhet për Vuçiqin dhe Thaçin, ndërsa ngjan se mesazhi për ushtruesen e detyrës së presidentes Vjosa Osmanin është shtyrë pas zgjedhjeve. Që të mos ngjajë si mbështetje elektorale për të?! Është plotësisht e vërtetë se presidenti Biden, njohës i shkëlqyer i rajonit, ka rol proaktiv në nxitjen e çlirimit të Kosovës, madje ai është i lidhur sentimentalisht me këtë vend, ku i biri i ndier ka punuar për një vit. Pra, mund të thuhet se senatori Biden ka vënë në lëvizje një proces

të rëndësishëm historik për shqiptarët. Por, ama ky proces që zgjat prej 22 vjetësh, mund të përmbillet, megjithatë, mu prej rivalit të tij, Trump. Atipiku Trump ofroi qasje të re në metodologjinë e dialogut, në tempizmin, por edhe në cilësinë e tij.

## Metodologjia e dialogut Kosovë - Serbi prej 1998- S

Ka një model të parë, ai i negociatave të Rambujesë, ku ndërmjetësonin evropianët, amerikanët dhe rusët bashkë. Kjo përbërje u ruajt dhe në negociatat e Vjenës në 2007, ku ekipi i Ahtisaarit kishte brenda dhe rusë. Në Vjenë rusët u distancuan në fund nga propozimi i ish-presidentit finlandez, duke mbetur pro "një zgjidhje që respektonte tri parime: jo ndarje, jo kthim në gjendjen e mëparshme, jo bashkim me një shtet tjetër". Dialogu rifilloi pas një rezolute të OKB-së së shtatorit 2010, me ndërmjetësimin e BE-së (baronesha Ashton dhe Mogherini), ku amerikanët e administratës Obama - Biden e mbështesnin nga jashtë dialogun. Me rusët duhej folur në fund. Ky ishte modeli i dytë.

Modeli i tretë: Grenelli, respektivisht administrata Trump, me arrogancë iu imponua BE-së, ndaq edhe për ta shitur si sukses elektorale: dialogun e ndërmjetësojmë ne, me rusët flasim ne, ju evropianët na ndiqni po të doni. Pra, një model ekskluzivisht amerikan, i bërë publik saktësisht më 18 dhjetor 2018 me një letër të presidentit Trump për Vuçiqin dhe Thaçi. I udhëhequr nga Grenelli, si i dërguar special, ambasador në Gjermani, shef i 17 shërbimeve sekrete. Ky model nisi të aplikohet dy vjet para votimeve presidenciale. Po kush e vonoi përmbylljen e dialogut me njohjen reciproke, për të cilin Trumpi në letrat e 15 shkurtit 2019, thotë se duhet të ishte në themel të marrëveshjes

gjithëpërfshirëse? Kush prej aktorëve të Kosovës riaktualizoi modelin evropian të dialogut, të cilin e konfirmoi me xhelozë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano? A nuk dështoi më 2019 moderimi gjerman; a nuk dështoi Samiti i Parisit i gushtit 2019 (me maska) memoderimin francez? A nuk ka shenja si propozimet inovative moderimi francez si u la të kuptohej nga takimi i fundit Macron-Vuqiç, pasi që serbët i kanë dhënë ndërtimin e metrosë në Beograd një kompanie të tyre? A nuk është degraduar pak dialogu me ndërmjetësimin e përbashkët të dy personazheve si Borrelli dhe Lajçaku, që përfaqësojnë vende jonjohëse? A ka lidhje liberalizimi i vizave me dialogun sipas modelit evropian? Sa ndikojnë zgjedhjet franceze apo të tjerat në dialog? Ekuacioni duket shumë i thjeshtë. Dialogu u vonua prej taksës, reciprocitetit, publikimit të aktakuzës për Thaçin e të tjerët dhe, për pasojë, ngjan se u vonua edhe njohja reciproke, me vetëdije apo pa vetëdije. Sa iu takon shqiptarëve, njëjtë si në Rambuje dhe në Vjenë, ata nuk u bënë bashkë, vepruan kundër modelit amerikan të dialogut që publikisht e donin shumë. Rezultati? Dialogu i shtatorit 2020 nuk u mbyll me njohjen reciproke. Zgjedhjet në Kosovë të 14 shkurtit 2021 mund të sjellin fitues shumë të qartë, por në dialogun me ndërmjetësim evropian duhet të shkohet menjëherë nëse kërkohen viza. Duhet unitet dhe me opozitën që të arrihen objektiva të mëdha si njohja reciproke. Në shtator 2020, siç e pohon dhe sot Vuçiqi, njohja reciproke ishte në nenin 10. Vuçiqi e kundërshtoi dobët mbajtjen e saj dhe, madje, futja e njohjes së Izraelit bëri që Serbia të mos firmoste në të njëjtin tekst me Kosovën. Në 2 muajt që mbetën deri në votimet amerikane, për shkak të vonesës nga aktorët kosovarë dhe sabotimi frankogjerman, administrata Trump nuk e bëri presionin deri në fund për njohjen reciproke. Po Bideni, si do të silltet?

## Sfida para Bidenit, por edhe udhëheqjes së Kosovës


A pritet të ketë dallime midis dy administratave, si ngjau në fushatat zgjedhore? Shenjat e para janë që jo. Në Senat, ndërsa votohej nominimi i tij, sekretari i shtetit Blinken, bashkëpunëtori i hershëm i presidentit Biden, tha se duartrokiste qasjen ekonomike të administratës Trump. Kjo qasje nuk ishte thjesht e Grenellit si duan ta banalizojnë manipulantët e hapësirës shqiptare, por e Shtëpisë së Bardhë (Këshilltarit të Sigurisë Kombëtare), e USAID, e DFC, e Sekretariatit të Energjisë dhe deri diku e Departamentit të Shtetit, sado që ai mund të jetë përjashtuar. Marrëveshja e shtatorit 2020, e cila polli marrëveshjen për mbështetjen e investimeve, për hapjen e zyrës së DFC në Beograd (Banka Amerikane e Investimeve), për projektet amerikane deri në 13 miliardë dollarë që kontrastojnë ndikimin ruso-kinez, mbetet në fuqi. Bideni ka sfidën e madhe: ta përmbyllë procesin që vetë e nisi 22 vjet më parë apo të humbë kohë duke ndenjur pas Evropës si bëri dikur administrata Obama... Të emërojnë të dërguar special të profilit të lartë si Grenelli, ta përfshijë këshilltarin e tij të Sigurisë Kombëtare, apo të presë prapa ish-kryediplomatit spanjoll Borrelli, i cili para pak ditësh dështoi para rusëve. Pra, Bideni është në trysni. Ose do të vijojë me mbështetjen e negociimit 100 për qind evropian, ose do të vijojë me modelin 100 për qind amerikan të Trumpit, ose do t'i tërheqë me forcë evropianët në një model të katërt. Me rusët ose do të duhet të negociojë terma të reja, ose do të ndërlidhet me termat e ndonjë akordi eventual midis Trumpit dhe Putinit në Helsinki!? Me apo pa njohje reciproke, kjo varet. Mirëpo, evropianët kanë në dorë kartën e vizave. Kush vonon dialogun, vonon vizat. Dhe ka një parim në diplomaci: sa më shumë të kërkosh, aq më shumë duhet të japësh. Kush është gati?

/Panorama/

## Përurohët Qendra "One Stop Shop" në Podujevë

PODUJEVË, 11 SHKURT (ER) - Me projektin "One Stop Shop", i cili u përuhua të enjten me dhjetë sportele të gjitha në një vend. Pra, në katin e parë të Administratës Komunale, do të ofrohen shërbime të shumta me standarde të larta, në një ambient modern e të digjitalizuar. "Pa pritje të gjata me

rend dhe rregull, tash qytetarët do të marrin shërbime publike të shpejta dhe efikase. Tani qytetarët, pos asaj që do të kenë shërbime më të thjeshta, e me kosto më të ulët kohor e financiar, do të kenë komunikim të drejtpërdrejt dhe transparent me zyrtarët komunal", ka njoftuar Komuna e Podujevës.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Berisha: Luajmë për kualifikim në rrethin e ardhshëm

Kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha, beson se “dardanët” mund të shënojnë fitore ndaj Luksemburgut dhe Sllovakisë. “Në ndeshjet e nëntorit nuk kam qenë unë, por prapë kemi disa mungesa. Entuziazmi është i madh. Po luajmë në vendin tonë. Shpresoj të përgatitemi sa më mirë. Kemi cilësi, por nëse nuk kemi lëndime, kemi gjasa për t’u kualifikuar tutje”, ka thënë Berisha

**PRISHTINË, 11 SHKURT** - Basketbollistët e Kosovës janë shumë të motivuar në përgatitjet dhe premtojnë maksimumin në përballje me Luksemburgun dhe Sllovakinë. Kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha, kishte munguar në ndeshjet e nëntorit, por tashmë është i gatshëm ta japë maksimumin nga vetja për “dardanët”. “Në ndeshjet e nëntorit nuk kam qenë unë, por prapë kemi disa mungesa. Entuziazmi është i madh. Po luajmë në vendin tonë. Shpresoj të përgatitemi sa më mirë. Kemi cilësi, por nëse nuk kemi lëndime, kemi gjasa për t’u kualifikuar tutje”, ka thënë Berisha për faqen zyrtare të FBK-së. Për herë të parë janë grumbulluar edhe dy lojtarë të rinj si Denis Zenelaj dhe Dion Sheqiri. “Po gëzohem që ka edhe lojtarë të rinj, që në të ardhmen do t’i ndihmojnë Kosovës”, ka deklaruar basketbollisti pejan, i cili, po ashtu, ka folur edhe për mungesën e tifozëve. “Sa herë kemi luajtur në shtëpi, përkrahja e tifozëve ka qenë e madhe. Ka qenë lojtari i gjashtë. Ne e dimë se po luajmë për shtetin dhe jam i bindur që secili do ta japë maksimumin. Do të na mungojnë shumë tifozët ‘dardanë’”, ka shtuar ai. Kosova A më 18 shkurt do të ballafaqohet me Luksemburgun, kurse më 20 shkurt me Sllovakinë. Përballjet zhvillohen



nga ora 19:00. Të dyja ndeshjet do të zhvillohen në Prishtinë, ashtu siç të gjitha takimet e Grupit B parakualifikues për Botërorin 2023. Në këtë grup, Islanda është lidere me tri fitore dhe një humbje, nga dy fitore kanë Kosova dhe Sllovakia, kurse Luksemburgu ndodhet në vendin e fundit me një fitore dhe tri humbje. Nëse “Dardanët”

shënojnë dy fitore në dy takimet e zhvilluara, atëherë do të kualifikohen në rrethin e ardhshëm. Të gjitha ndeshjet e Dritares së Tretë të Grupit B do të zhvillohen në Prishtinë. Ky ishte vendimi i mëhershëm nga Bordi i FIBA Evropës, duke i besuar edhe një ngjarje të rëndësishme Federatës së Basketbollit të Kosovës.

## Dukagjini kualifikohet në çerekfinale të Kupës

Prishtinë, 11 shkurt - Të enjten është zhvilluar ndeshja e fundit e fazës së 1/8 së finales së Kupës së Kosovës, ku Dukagjini ka shënuar fitore në duel me 2 Korrikun me rezultat 3-1. Skuadra klinase kaloi në epërsi në minutën e 17 me golin e Mark Milicajt, ndërsa pak para përfundimit të pjesës së parë prishtinasit e realizoi Euron Leci. Kështu, në fazën çerekfinale do të marrin pjesë Dukagjini, Prishtina, Llapi, Drenica, Feronikeli, Trepça '89, Istogu dhe A & N.

Dominimi i vendësve vazhdoi edhe në pjesën e dytë, që u konkretizua edhe me golin e tretë, të cilin e realizoi Altin Merlaku nga penalltia. Ndërkaq, golin e vetëm për prishtinasit e realizoi Euron Leci. Kështu, në fazën çerekfinale do të marrin pjesë Dukagjini, Prishtina, Llapi, Drenica, Feronikeli, Trepça '89, Istogu dhe A & N.



### SHKURT

#### Marku për duelin me Charltonin: Edhe 10 ditë dhe do ta shihni

Florian Marku po përgatitet për duelin e radhës kundër Rylan Charltonit. Kjo betejë do të zhvillohet në Londër më 20 shkurt dhe boksieri shqiptar po përgatitet që të fitojë, ndryshe nga se ndodhi më 12 dhjetor kundër Jamie Stewart. Më këtë të fundit barazoi, por në shënjestër përfundoi gjyqtari i ndeshjes. Dominimi i Markut nuk u vu re nga ai dhe në fund shpalli rezultatin përfundimtar 76-76. “Më 20 shkurt nuk do ta lë ndeshjen në duart e gjyqtarëve”, shkruante para pak kohësh Marku, i cili mezi e pret duelin me britanikun Charlton. Në orët e vona të ditës së enjte boksieri shqiptar ka ngacmuar sërish, teksa në rrjetet sociale ka publikuar një video me mesazhin: “Edhe 10 ditë dhe do ta shihni”.

#### Drejtori i Sociedadit: Duam që Januzaj të mos largohet

Adnan Januzaj mund të vazhdojë të luajë në Spanjë te Real Sociedad. Mesfushori shqiptar po vazhdon të shkëlqejë në fanellën e Real Sociedadit dhe klubi spanjoll po mendon që ta shpërblejë ish-futbollistin e Manchester Unitedit. Lajmi është konfirmuar nga drejtori sportiv i Real Sociedadit, Roberto Olabe, i cili ka konfirmuar bisedimet për zgjatjen e kontratës me lojtarin nga Kosova. “Si me Adnanin, ashtu edhe me Jon Guridin dhe Monrealin jemi në bisedime. Nëse më pyet, unë do të dëshiroja që Adnani të qëndronte. Evolucionin që Januzaj ka pasur që kur ka mbërritur këtu deri më tash ka qenë sinjerisht pozitiv. Të gjithë e dimë se çka është në gjendje të japë në fushë. Shpresojmë se ai do të shohë një mundësi në Real Sociedad”, ka thënë Olabe. 26-vjeçari u transferua te Sociedadadi në verën e vitit 2017 nga Manchester Unitedi, ndërsa ka kontratë deri në verën e vitit 2022. Deri tani numëron 104 paraqitje dhe ka shënuar 16 gola. Këtë edicion, në 20 ndeshje në të gjitha garat ka shënuar dy gola dhe ka asistuar dy herë.

#### Mediumi i njohur italian: Muriqi ka filluar ta tregojë potencialin e vërtetë

Kur Lazio transferoi Vedat Muriqin nga Fenerbahçe për 17.5 milionë euro u bë bujë e madhe në të gjitha mediat italiane dhe jo vetëm. Drejtori sportiv, Igli Tare, ishte duke e monitoruar lojtarin për një kohë të gjatë, teksa transferimi u zyrtarizua në vitin e kaluar. Muriqi kaloi te Lazio, pasi kaloi një sezon të jashtëzakonshëm me Fenerbahçen, duke shënuar 19 gola në të gjitha garat. Megjithatë, sulmuesi shtatlartë nuk e filloi mbarë aventurën në Itali pasi u përballë me lëndime e koronavirus, duke mos qenë kështu zgjedhja e parë e Simeone Inzaghit. Por, viti 2021 ka nisur shumë më mirë për ish-sulmuesin e Lirisë së Prizrenit, të cilit ia kanë kushtuar një artikull edhe ‘thelaziali.com’. Në këtë artikull është cekur paraqitja e mirë e Muriqit në derbin ndaj Romës, ndaj Parmës në Kupën e Italisë ku dhuroi një asistim, për të vazhduar pastaj me paraqitjen e mirë ndaj Sassuolos në Serinë A dhe paraqitjes ndaj Atalantas në Kupë, ku prizrenasi shënoi edhe gol. Pavarësisht se ishte një fillim jo i mirë, ‘thelaziali.com’ ka shkruar se Vedat Muriqi tani po tregon potencialin e tij të vërtetë. E gjitha se çfarë duhet tani, sipas tyre, është besimi te lojtari.


## Rossi: Nuk mund ta fal kurrë Marquezin për atë që më ka bërë

ROMË, 11 SHKURT - Piloti italian Valentino Rossi dhe ai spanjoll Marc Marquez janë dy nga talentet më të mëdhenj të MotoGP në 20 vjetet e fundit. Gjithsesi, mes tyre nuk ka një marrëdhënie të mirë, ndërkohë që konfliktet mes tyre kanë

lindur që në vitin 2015. Atë vit titullin e fitoi Jorge Lorenzo, ndërkohë që Rossi akuzoi Marquezin për pengim në garë dhe se ndihmoi patriotin e tij. "A do ta falë Marquez? Kjo gjë është e pamundur. Ajo që më ka bërë nuk mund të falet. Kur mendoj për ato ditë kam

të njëjtën ndjesi si atëherë edhe pse kanë kaluar 6 vjet. Më duket e vështirë apo e pamundur që ndjenjat apo gjërat brenda meje të ndryshojnë", ka thënë Valentino Rossi. Marquezin e mbylli vitin 2020 pa asnjë pikë (u rrëzua në të

parën dhe u operua 3 herë). Duke folur për situatën e rivalitetit të tij, Rossi ka shtuar: "E thënë në mënyrë diplomatike, më vjen keq që ai nuk arrin të garojë. Nëse do të shërohet, gjë të cilën asnjë nuk e di se kur do të ndodhë, besoj se do të rikthehet i fortë si dikur.



Gabimi i tij ishte dëshira të rikthehej në garë sa më shpejt pas operacionit".

## Marmarinos: Duhet të luajmë me krenari, përfaqësojmë Kosovën

PRISHTINË, 11 SHKURT - Basketbollistët e Kosovës po vazhdojnë përgatitjet për parakualifikimet e Kupës së Botës 2023. Stërvitjet kanë filluar nga e marta dhe tashmë po zhvillohen dy herë në ditë. Përzgjedhësi i Kosovës, Christos Marmarinos, ka folur për rrjedhën e përgatitjeve. "Kjo është dita e tretë e stërvitjeve dhe deri më tani po shkojnë shumë mirë. Kemi një ekip të kombinuar mes lojtarëve me përvojë dhe atyre të ri. Ne jemi duke u përgatitur për të ardhmen dhe njëkohësisht për të tashmen, ku kemi dy ndeshje ndaj Luksemburgut dhe Sllovakisë", ka thënë përzgjedhësi i Kosovës për faqen zyrtare të FBK-së dhe T7. "Dardanët" do të luajnë në shtëpi, por pa ndihmën e tifozëve. "I kuptojmë vështirësitë me Covid-19, ku lojtarët ende nuk janë 100 % të formës fizike, por u kam thënë djemve se duam të sjellim energji pozitive, sepse përfaqësojmë shtetin, përfaqësojmë Kosovën. Të luash në Kosovë është shumë mirë, por pa tifozë është e tmerrshme, megjithatë lojtarët duhet të mësohen. Pa mbështetjen e tifozëve është sikur të mungon një element shumë i rëndësishëm në lojën tonë", ka deklaruar Marmarinos. Ai foli për ardhjet e reja, Denis



Zenelaj dhe Dion Sheqiri. "Ata vijnë nga vende të tjera, nga kategori të tjera. Jemi duke u munduar t'i ndihmojmë dhe të adaptohen në ekipin tonë", u shpreh Marmarinos, i cili foli edhe për gjendjen e Gëzim Morinës dhe Drilon Hajrizit. "Varet nga rekomandimet e mjekëve nëse do të jenë në gjendje të luajnë. Nëse do të luajnë do të jetë mirë, nëse jo do të mundohemi ta mbulojmë hapësirën e krijuar", ka deklaruar Marmarinos. Kosova A më 18 shkurt do të ballafaqohet me Luksemburgun, kurse më 20 shkurt me Sllovakinë. Përballjet zhvillohen nga ora 19:00. Të dyja ndeshjet do të zhvillohen në

Prishtinë, ashtu siç të gjitha takimet e Grupit B parakualifikues për Botërorin 2023. Në këtë grup Islanda është lidere me tri fitore dhe një humbje, nga dy fitore kanë Kosova dhe Sllovakia, kurse Luksemburgu ndodhet në vendin e fundit me një fitore dhe tri humbje. Nëse "dardanët" shënojnë dy fitore në dy takimet e zhvilluara, atëherë do të kualifikohen në rrethin e ardhshëm. Të gjitha ndeshjet e Dritares së Tretë të Grupit B do të zhvillohen në Prishtinë. Ky ishte vendimi i mëhershëm nga Bordi i FIBA Evropës, duke i besuar edhe një ngjarje të rëndësishme Federatës së Basketbollit të Kosovës.

## Lakersat triumfojnë në kohën shtesë ndaj Oklahomas



LOS ANXHELOS, 11 SHKURT - Koha shtesë i ka buzëqeshur sërish skuadrën së Lakersat në fitoren 114-113 ndaj Oklahomas, e dyta radhazi brenda 48-orësh ndaj të njëjtit rival. Mungesa e Davisit ndihet te lakersat, ndërkohë

që LeBron Jamesi bëri detyrën, duke realizuar 25 pikë. Nuk ka të njëjtin fat ekipi i Milwaukeees, që u mund 125-124 në sekondat e fundit nga Phoenix. Antetokounmpo e mbylli me 47 pikë e 11 rebounde, por që s'mjaftuan

për ta shmangur humbjen. Për Phoenixin u dalluan Booker me 30 pikë e Pauli me 28 pikë. Fiton edhe skuadra e Clippersit, që mundi 119-112 Minnesotan, me Leonardin protagonist, autor i 36 pikëve. Rikthehet te fitorja ekipi i Brooklynit, që mundi 104-94 Indianan, ndeshje ku u dallua Irvingu me 35 pikë, lider në fushë për Netsin.

### REZULTATET

Washington - Toronto	115-137
Dallas - Atlanta	118-117
Brooklyn - Indiana	104-94
Memphis - Charlotte	130-114
Minnesota - Clippers	112-119
Chicago - New Orleans	129-116
Denver - Cleveland	133-95
Lakers - Oklahoma	114-113
Phoenix - Milwaukee	125-124

### SHKURT

#### Ronaldo në Juventus deri në vitin 2023

Ylli portugez Cristiano Ronaldo do të jetë pjesë e Juventusit deri në verën e vitit 2023. Mediumet italiane kanë raportuar të enjten se portugezi është pajtuar ta rinovojë kontratën që i skadon në vitin 2022 edhe për një vit tjetër. Thuhet se marrëveshja mes palëve është arritur dhe gjithçka pritet të bëhet zyrtare brenda këtij muaji. Detajet e marrëveshjes së re të Ronaldos nuk janë zbuluar, por portugezi aktualisht te Juventus ka një pagë vjetore prej 30 milionë eurosh. Sulmuesi 36-vjeçar këtë sezon ka shënuar 23 gola në 25 paraqitje për Juventusin në të gjitha garat. Ai është pjesë e Juventusit prej vitit 2018 kur u transferua nga skuadra e Real Madridit.

#### Crespo, afër marrëveshjes me Sao Paolon

Hernan Crespo është i gatshëm për një aventurë të re në karrierën e tij. Ish-sulmuesi i Interit do të jetë trajneri i ri i skuadrës së Sao Paolos. Trajneri argjentinas do të udhëtojë drejt Brazilit në ditët e ardhshme për të firmosur një kontratë të re me klubin brazilian. Këtë akord e përcjell media argjentinasë "OLE" e cila deklaroi se ka një akord për një kontratë dyvjeçare me argjentinasin që pritet ta trajnojë edhe ish-lojtarin e Barcelonës dhe Juventusit, Dani Alves. Crespo më parë ka trajnuar skuadra si Parma U-19, Modena dhe në vendlindje skuadrat Banfilld dhe Defensas.

#### Guardiola, pas rekordit historik: Më e mira s'ka ardhur ende

Manchester City e mposhti Swansea në 1/8-at e FA Cup me shifrat 3-1 dhe u kualifikua në çerekfinale. E sotmja ishte fitorja e 15-të radhazi për skuadrën e Guardiolas, rekord historik për elitën e futbollit anglez. Pep Guardiola arriti shifrën e 200 fitoreve me "Qytetarët". Ai e ka drejtuar Cityn në 277 ndeshje dhe është mundur vetëm 37 herë. "Kisha mendimin se ata do të krijonin rrezik në sulm. Ishin shumë agresivë, por ne ishim më të mirë për krijimin dhe organizimin e aksioneve për shënim. Më vjen keq që nuk i shënuam të gjitha rastet, por unë jam i kënaqur. Jam krenar që kemi arritur 15 fitore radhazi. Rekordet janë për t'u thyer. Nuk është e lehtë në futbollin modern për të arritur një seri të tillë të gjatë, jemi të lumtur për klubin. 200 fitore me Cityn? Janë shumë, por kemi ende para për të arritur. Më e mira nuk ka ardhur ende. Shpresojmë të jetë fillimi i një vargu suksesesh", u shpreh Guardiola.

#### Lippi: Interi, favorit për 'Scudetto'

Marcello Lippi ka thënë se Interi ka "një përparësi" në luftën për "Scudetton", pasi që do të fokusohet në vetëm një ndeshje në javë në Serinë A. Milani është i pari në Serinë A, dy pikë mbi Interin në vendin e dytë, me Juventusin që ka shtatë pikë më pak, por me një ndeshje më pak se liderët. Me Interin jashtë garave të Kupës tani do të fokusohet vetëm në ligë, kurse Lippi beson që zikaltrit kanë "një përparësi që nuk duhet të nënvlerësohet", por ka theksuar se "garat e mëdha" kërkojnë edhe energji më shumë. "Ende ka shumë kohë deri në fund të kampionatit dhe shumë gjëra duhet të merren në konsideratë. Këtu kemi të bëjmë nga përkushtimi. Disa ende janë në Ligën e Kampionëve, të tjerët në Coppa Italia dhe në çdo rast këto gara do t'ua shkatërrojnë kampionatin", ka thënë Lippi. "Disa të tjerë kanë ndeshje në Evropa Ligë dhe një skuadër vetëm në kampionat e ku aty ata do të fokusohen në vetëm një ndeshje për një javë. Kjo është një përparësi që nuk bën të nënvlerësohet. Garat e mëdha kërkojnë shumë energji, por në gara të gjata sa më pak ndeshje atëherë ata janë favoritë. Në fund mendoj se Milani, Interi dhe Juventus kanë 33 për qind shans që ta fitojnë 'Scudetton'", ka deklaruar Lippi.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES  
AGJENCIA PËR ARSIMIN DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIMIN PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:94/1  
Dt:11.02.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

### SHPLLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Shkollën e Mesme të Makinerisë "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë për vitin shkollor 2021/2022

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
Sh M L	Sh. M. M "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtinë	Një(1) mësimdhënës/e për lëndën e Gjuhës dhe letërsisë shqipe 20 orë mësimore;  Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Edukatës Fizike dhe shëndetësore me 10 orë mësimore;	Zëvendësim deri në kthimin e mësimdhënësit nga pushimi pa pagës  Vend i lirë

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi ( fotokopje );
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysnë, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

#### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Shkollën e Mesme të Makinerisë "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë .

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Virtual Tech" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811315523 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Virtual Tech" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811315523, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Virtual Tech" L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811315523, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

### >> SHPLLJE TË VOGLA <<

► Alban Susuri shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Naim Frashëri " Vlashnje.

► Muharem Duraku shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Bajram Curri " Krushe e Madhe.

► Etnik Omaj shpall të pavlefshme dëftesat certifikatën diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

	REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E SUHAREKES OPSTINE SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	--	---

**DREJTORIA E ARSIMIT**  
05nr. 256 datë 10.02.2021

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, UA nr.10/2018 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm), UA nr.05/2015(Normativit për mësimdhënësit e arsimit profesional),Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall këtë:

**K O N K U R S**

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2020/2021

- 1.SHMT"Skender Luarasi"-Suharekë
  - Një mësimdhënës/e për lëndët e arkitekturës për 14 orë mësimi në javë .
- 2.Gjinnazi"Jeta e re"-Suharekë
  - Një mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe për 15 orë mësimi në javë (7 orë në Gjinnaz,4 orë në SHIFMU"7 Marsi"-Suharekë dhe 4 orë në SHIFMU"Destan Bajraktari"-Suharekë).
3. SHFMU " 28 Nëntori " në Dobërdelan
  - Një mësimdhënës/e për mësim klasor me kohë të caktuar(deri në përfundimin e mandatit të drejtorit).
  - Një mësimdhënës/e për lëndën e cdukatës qytetare për 10 orë mësimi në javë.
  - Një mësimdhënës/e për lëndën fizikë- kimi
- 4.SHFMU"Edit Durham" në Mushtisht-parallelja në Delloc
  - Një mësimdhënës/e për mësim klasor .
  - Një mësimdhënës/e për mësim klasor për kohë të caktuar (deri në përfundimin e mandatit të drejtorit).
- 5.SHFMU " Kongresi i Manastirit " në Studencan
  - Një mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës shqipe për 18 orë mësimi në javë .
  - Një mësimdhënës /e për mësim klasor për kohë të caktuar deri më datë 31.08.2021.
- 6.SHFMU " Dituria " në Samadraxhë
  - Një mësimdhënës/e për mësim klasor .
- 7.SHFMU " Sadri Duhla " në Duhël
  - Një mësimdhënës/e për lëndën e historisë për 10 mësimi në javë ( 2 orë Duhël,8 orë në L.e Sopës).
  - Një mësimdhënës për lëndën e gjeografisë për 10 orë mësimi në javë (7 orë gjeografi në Greqeç dhe 3 orë gjeografi në L.e Sopës).
- 8.SHFMU " Shkëndija " në Suharekë
  - Një mësimdhënës/e për mësim klasor (zëvendësim i pushimit të lehonisë).


**Kushtet:** Për këto vende të lira të punës të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHI nr 05/2015 dhe UA-MASHI nr.10/2018.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:



- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Diploma e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje).
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim, (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHI(nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës. Afati i konkurimit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë.

Për orarin e intervistimit do të informoheni në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së



Drejtori i DKA-së  
Remzi Bajselmani

	REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E SUHAREKES OPSTINE SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	--	---

**DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE**  
**05 br.256 od 10.02.2021 godine**

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03 / L-212, člana 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosova br. 04 / L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosova br. 03 / L-068, AI br.10 / 2018 (Normativa o stručnim kadrovima opšteg obrazovanja), AU br.05 / 2015 (Normativa za nastavnike stručnog obrazovanja), Administrativnog uputstva br.07 / 2017 o regulisanju procedura za osnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, Opštinska direkcija za obrazovanje objavljuje sledeće:

**K O N K U R S**

Za popunu slobodnih radnih mesta za školsku godinu 2020/2021

- 1.STŠ"Skender Luarasi" u Suvu Reku
  - Jedan nastavnik/ca za predmet arhitektura za 14 časova nedeljno
- 2.Gjinnazije "Jeta e re" u Suvu Reku
  - Jedan nastavnik/ca za predmet albanskog jezika za 15 časova sa dopunom časova u drugim školama.
3. OSNŠ "28 Nëntori"-Dobërdelane
  - Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu(do zaveršetka mandata direktora škole)
  - Jedan nastavnik/ca za predmet građansko vaspitanje za 10 časova
  - Jedan nastavnik /ca za predmet fizika-hemija
- 4.OSNŠ "Edit Durham" Mušutište-Delovce
  - Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu
  - Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu (do zaveršetka mandata direktora škole)
- 5.OSNŠ „Kongresi i Manastirit“ –Studencane
  - Jedan nastavnik/ca za predmet albanskog jezika jezika za 18 časova
  - Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu,( na određeno vreme do 31.08.2021 godine)
- 6.OSNŠ"Dituria" u Samadraxhe
  - Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu
- 7.OSNŠ „ SHFMU " Sadri Duhla " –Duhle
  - -Jedan nastavnik/ca za predmet Istorie za 10 časova (2 časova u Duhle,8 časova L.Sopes)
  - -Jedan nastavnik/ca za predmet geografije 10 časova(7 časova u Greqeçe,3 časova L.Sopes)
8. OSNŠ " Shkëndija " –Recane
  - Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu(zamena za nastavnicu na porodiljsko odsustvo).

Uslovi: -Za ova slobodna radna mesta objavljena na konkursu potrebna je odgovarajuća stručna sprema prema normative AU MONT br. 10 / 2018 i AU MONT- 10/2015.

Dokumentacija potrebna za konkurs:


- Obrazac (prijava) koji kandidat popunjava
- Diploma ili potvrda stepena stručne spreme umesto diplome, koja ne sme biti starija od šest meseci (fotokopija).
- Izvod rođenja
- Lična karta (fotokopija)
- Dokaz o radnom iskustvu u obrazovanju (ako ga ima)
- Potvrda za obuke akreditovane od MONT-a (ako ga ima)

-Kompletirani dokumenti se dostavljaju fotokopirano, dok će se originalni dokumenti predstavljati u intervjuu. Komisija neće razmatrati nepotpune i dokumenta prispela nakon isteka roka.

Prijave se primaju i predaju u Prijemnu Kancelariju u Opštini Suva Reka.

Konkurs ostaje otvoren 15 (petnaest) dana od dana objavljivanja u novinama.

**O rasporedu intervjuva bićete obavesteni na web stranici Opštine Suva Reka i oglasnoj tabli ODO.**



Direktor ODO  
Remzi Bajselmani



#PDK134

Ramë  
VATAJ

25

#Rimëkëmbje

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS



#PDK134

**Hisen BERISHA** **53**

**#Rimëkëmbje**  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS



**VOTO 135** 

Prof. Asoc. Dr.  
**SHKELQIM MILLAKU**

**54**

**RAMUSHI 2021**  
PËR PRESIDENT

★ ★ ★ ★ ★ ★  
**FORÇA E KOSOVËS**

  
ALIANCA PËR ARDHMËRINË e KOSOVËS  
ALLIANCE FOR THE FUTURE OF KOSOVO





**#PDK134**

**69**

**Safete MALIQI**  
**QORMEMETI**

**#Rimëkëmbje**  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

**PDK 134**



**Prof. Dr. Bekim HAXHIU**  
**KAMISHI**

**109**

**#Rimëkëmbje**  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS



#PDK134

**83**

**Bujar  
KUKLECI**

#Rimëkëmbje  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

#PDK134  
**8 Bajrush  
Xhemali**  
#Rimëkëmbje  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

**Shteti.  
Shtet.**

**44**  
**Jetlir  
Zyberaj**

**135**

**5** **BESNIK TAHIRI**  
\* \* \* \* \*  
**FORÇA E KOSOVËS**

**127**

**SHQIPE MEHMETI SELIMI**

**10**

**#krejtdhedrejt**

**ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funado Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

**MEKA**  
HALAL FOOD

**PASHTETË PULE**

gluten free

çilësi e garantuar

pa konservues

#PDK134

1

**Enver  
HOXHAJ**

**#Rimëkëmbje**  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

**121 NISMA**  
SOCIALDEMOKRATE

**ME  
ÇLIRIMTARËT!**

**11 BEKIM BRESTOVCI**